



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:142963

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05752438

C.nr. 680/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Shemsedin Haxhiaj në çështjen juridike kontestimore, të paditëses M.R, nga fsh. D.... Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson SH.M-F avokate nga Istogu, kundër të paditurve F.R dhe M.R.1 që të dy nga fshati D...., Komuna e Istogut, nga baza juridike: pengim posedimi, në prezencën e paditësit s’bashkua me të autorizuarën, si dhe të paditurve, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 27.05.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses M.R, nga fsh. D.... Komuna e Istogut, me të cilën ka kërkuar që të VËRTETOHET së të paditurit F.R dhe M.R.1 që të dy nga fshati D...., Komuna e Istogut, e kanë kryer aktin e pengim posedimit në pjesën jug-perëndimore të ngastrës ./., aty ku gjenden dyert e hyrjes (me ngjyre të kaltër), për në oborr me dimensione me gjerësi prej 3.77m me lartësi prej 1.40m, me korniza metali dhe tela rrjetë, dhe kufizohet me këto parcela fqinjë, në anën veriore në drejtimin e shtrirjes perëndim-lindje, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale .-. e cila evidentohet në pronësi të P.Sh.e mirë e fshatit me gjatësi të tërësishme prej 31.29m nga pika detalit 1 deri në pikën nr.21, në anën lindore në drejtim të shtrirjes veri-jug, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelat kadastrale .-. dhe .-. në pronësi të M.R.1, me gjatësi të tërësishme prej 55.23 m, nga pika e detalit 2 deri në pikën nr.5 përgjatë pikave thyerëse nr.3,4, në anën jugore përgjatë kësaj gjatësie kufizohet me ngastrën .-. , e cila evidentohet në pronësi të P.Sh. rrugët publike me gjatësi prej 24.65m, nga pika e detalit nr.3 deri në pikën nr.6, në anën perëndimore përgjatë kësaj gjatësie kufizohet me ngastrën .-. , e cila evidentohet në pronësi të S.K me gjatësi prej 30.98m, nga pika e detalit nr.3 deri në pikën nr.1, si dhe të Urdhërohen të paditurit që në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi të mos e pengojnë paditësen në pronën e saj konkretisht në ngastrën e lartcekur.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarës së saj me padi si dhe në precizimet e saj me parashtresat e datës 22.09.2023 dhe 03.05.2024, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të vërtetohet së të paditurit F.R dhe M.R.1 që të dy nga fshati D...., Komuna e Istogut, e kanë kryer aktin e pengim posedimit në pjesën jug-perëndimore të ngastrës .-. , aty ku gjenden dyert e hyrjes (me ngjyre të kaltër), për në oborr me dimensione me gjerësi prej 3.77m me lartësi prej 1.40m, me korniza metali dhe tela rrjetë, dhe kufizohet me këto parcela fqinjë, në anën veriore në drejtimin e shtrirjes perëndim-lindje, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale .-. e cila evidentohet në pronësi të P.Sh.e mirë e fshatit me gjatësi të tërësishme prej 31.29m nga pika detalit 1 deri në pikën nr.21, në anën lindore në drejtim të shtrirjes veri-jug, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelat kadastrale .-. dhe .-. në pronësi të M.R.1, me gjatësi të tërësishme prej 55.23 m, nga pika e detalit 2 deri në pikën nr.5 përgjatë pikave thyerës nr.3,4, në anën jugore përgjatë kësaj gjatësie kufizohet me ngastrën .-. , e cila evidentohet në pronësi të P.Sh. rrugët publike me gjatësi prej 24.65m, nga pika e detalit nr.3 deri në pikën nr.6, në anën perëndimore përgjatë kësaj gjatësie kufizohet me ngastrën .-. , e cila evidentohet në pronësi të S.K me gjatësi prej 30.98m, nga pika e detalit nr.3 deri në pikën nr.1, si dhe të Urdhërohen të paditurit që në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi të mos e pengojnë paditësen në pronën e saj konkretisht në ngastrën e lartcekur.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditëses, ka deklaruar se mbes pranë padisë, parashtresës mbi preciziminë e kërkesëpadisë, si dhe deklarimeve të dhëna në seancë të shqyrtimit kryesorë, e më pa mëdyshje gjatë këtij shqyrtimi kryesor u vërtetua se paditësja pengohet në vazhdimësi nga këtu të paditurit, ku edhe nga deklaratimet e tyre pranë kësaj gjykate kishin pranuar që të largohet nga shtëpia, me arsyetimin se kinse atë ka kush e trashëgon, po ashtu nga deklaratimet e vet paditëses më pa mëdyshje u vërtetua gjendja e saj psikologjike e shkaktuar nga presioni i të paditurve, e cila disa herë është detyruar të shkojë pranë SP. Nga presioni i tyre, e cila ka një gjendje jo të mirë shëndetësore. Nga dëshmitari pranë kësaj gjykate e vërtetoi rrethanën se e njëjta pengohet nga të paditurit në shfrytëzimin e oborrit dhe shtëpisë. Po, ashtu ai vërtetoi se përveç tij ishin të njohur edhe fqinjët për rreth, andaj pengim posedimi ka të bëjë me çfarëdo mënyre apo forme që të pengohet në shfrytëzimin e një të drejtësi poseduese e fundit faktike, andaj kjo u vërtetua gjatë këtij shqyrtimi, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar, ndërsa paditësen të mos e pengojnë, të mos e shqetësojnë dhe ta lejon ta shfrytëzoi në mënyrë të qetë shtëpinë dhe oborrin pa asnjë pengesë. Si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë: për përpilimin e padisë në vlerë prej 104 euro, për taksën gjyqësore në vlerë prej 50 euro, për ekspertizën e ekspertit gjeodet në vlerë prej 195 euro dhe për tri seanca në vlerë prej 135 euro e në total për të gjitha seancat në shumën 405 euro.

I padituri i parë në seancën përgatitore ka deklaruar se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi mirëpo e kam parë të arsyeshme që drejtpërdrejte në seancë të deklarohem lidhur sa i përket këtij kontesti duke e kontestuar padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar si dhe duke shtuar se pasi vdekjes së vëllait cermonin e varrimit të vëllait e kam kryer unë dhe pas vdekjes së tij në konsultim me motrën këtu të paditurën e dytë e kemi pasur të arsyeshme që të ja japim në posedim paditëses, por pa investime pasi që ajo shtëpi ka trashëgimtar. E paditura e dytë ka deklaruar se e mbështetë në tërësi deklarinimin e të paditurit të parë. Ndërsa gjatë shqyrtimit

kryesor dhe në fjalën përfundimtare njëzëri kanë deklaruar se mbeten pranë përgjigjes në padi, kundërshtimeve të dhëna në vazhdimësi nga seanca e parë e deri në fund, duke shtuar se janë të pa vërteta pretendimet e paditëses dhe përfundojnë njëjtë, kërkoj pagesën e shpenzimeve të krijuara rreth këtij kontesti, edhe unë pisiqikisht nuk jam në rregull për shkak të telasheve që na i ka krijuar në familja ajo, kjo nuk është duke jetuar aty, por është duke jetuar me dëshmitarin e dëgjuar më herët D.. Kohë pas kohe vjen vetëm sa me përzi punën dhe me i thirr policinë, në bazë të këtyre i propozoj gjykatës që të refuzohet padia, le të vendos për kërkesën për trashëgimi me të gjithë trashëgimtarët pretendet dhe të deklarohet për sipërfaqen prej 40 ari e cila nuk figuron si masë trashëgimore dhe të merr pjesën e vetë e cila i takon sipas ligjit.

Gjykata në këtë çështje juridiko - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Certifikata pronësore me nr./ e datës 14.04.2023, kopja e planit e datës 14.04.2023, aktvendimi i Gjykatës Komonale në Istog T.nr./ i datës 20.02.2002, 2 foto të dyerve të oborrit dhe rrugës për çasje nga pjesa perendimore e ngastrës së lartëcekur, certifikata pronësore e dt. 21.09.2023, fleta poseduese me nr. 249/2002 i dt. 02.12.2002, formulari i vlerësimit social për ndërtimin e

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në cilësi të provës materiale ka nxjerrë ekspertizën e ekspertit gjeodet GJ.M të datës 15.01.2024, i cili e ka bërë identifikimin, përshkrimin e njësisë kadastrale, nr.-. dhe matjen e pjesës ku pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit. Parcela kadastrale ./ në regjistrat kadastral evidentohet në bashkëpronësi të M. (R.1) R. ¼, M.1 (R.1) R. ¼, Fadil (R.1) R. ¼ dhe XH. (R.1) R. ¼ në Z.K. D...., Komuna e Istogut. Parcela kadastrale me nr. të njësisë ./ me sipërfaqe të tërësishme prej 1253m² shtrihet/ndodhet në Z.K. D...., vendi i quajtur “...” me kulturë pemishte e klasës së 3, shtëpi dhe oborr. Kjo parcelë shtrihet në distancë prej 36m prej rrugës publike Istog – D... “...” në krahun e djathtë dhe kufizohet me këto parcela fqinje: Nga ana veriore në drejtim të shtrirjes Perendim kah Lindja, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./ e cila evidentohet në pronësi të P.Sh. e mirë e fshatit me gjatësi të tërësishme prej 31.29m nga pika e detalit 1 deri në pikën nr. 2, në teren nga kjo anë ka një pjesë rrethojë me tela rrjetë, gardh dekorues, si dhe themel betoni. Në anën lindore në drejtim të shtrirjes veri kah jugu, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./ dhe ./ në pronësi të M.R.1 me gjatësi të tërësishme prej 55.23m, nga pika e detalit 1 deri në pikën nr.5, përgjatë pikave thyese nr.3,4, ku përgjatë kësaj gjatësie në teren ka rrethoje prej telave rrjetë me hunjtë druri. Në anën jugore përgjatë kësaj pjese të gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./ e cila evidentohet në pronësi të P.Sh. Rrugët Publike, me gjatësi prej 24.65m, nga pika e detalit nr. 3 deri në pikën nr. 6, ku përgjatë kësaj ane në teren ka rrethojë me tela rrjetë dhe hunj druri si dhe drunjte bagreni. Në anën perëndimore përgjatë kësaj pjese të gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./, e cila evidentohet në pronësi të S.K, me gjatësi prej 30.98m, nga pika e detalit nr.6 deri në pikën nr.1 ku përgjatë kësaj gjatësie në teren gjendet rrethoja me tela rrjetë dhe shtylla betoni, hunjtë druri, gardh dekorues si dhe drunjte bagremi. Brenda parcelës gjenden të ndërtuara dy shtëpi banimi në etazhitet P+0, njëra në skajin verior (paditurve), ndërsa tjetra në skajin jugor (paditësja). Parcela ka shfrytëzim aktual shtëpi, oborr dhe një pjesë pemishte me kopsht. Pozicioni ku pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit gjendet në pjesën jug-perëndimore të parcelës ./ ku gjenden dyert e hyrjes për

në oborr me dimensione me gjerësi prej 3.77m me lartësi prej 1.40m, me korniza metali dhe tela rrjetë.

Me qëllim të vërtetimit sa me të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor është bërë edhe procedimi i palëve, pala paditëse M. R. e cila ka deklaruar: me datë 13.04.2023 F. më ka thënë me dal prej aty, ndërsa me datë 15.04.2023 ka qenë kërkesa e njëjtë që unë ta liroj atë shtëpi, ndërsa me dt. 01.06.2023 unë atë ditë e kam thirrë një punëtor me pastrua oborrit dhe rrugën ku kaloj, ka ardhur punëtori ka filluar që të punoj ka kryer pak, pas asaj kohe ka dalur F. nga shtëpia në oborr dhe i ka thënë punëtorit lëngove dil dhe shtini pulat brenda dhe atë urgjent pasi që dera e oborrit ka qenë pak e hapur dhe atë e kam e hap unë dhe jo që e kam bërë me qëllim por për shkak të punëve që kam kryer jam ngatërruar, dhe unë aty kam ndërhyrë duke i thënë punëtorit le se unë merrem me këtë punë dhe i kam thënë se çka je ka donë, ka filluar që të më ofendoj me fjalë të ndryshme, unë i kam thënë të më lëri të qetë por ofendimet e tij kanë vazhduar dhe jam dal dhe e kam thirrur policinë. Po ashtu ka deklaruar se jetojnë në shtëpinë e vëllait të ndjerë XH. R. që dy vite dhe se të gjitha shërbimet komunale i paguaj unë dhe se jam penguar nga F. në mënyrë verbale më ka thënë “kurvë”, “prostitutë” dhe më ka thënë që të dal nga aty se unë e kam pastruar atë vetë pa më ndihmuar askush dhe herën e parë më ka mbrojtur M.1 në vitin 2022, ndërsa herën e fundit kur ka ndodhur është datë e cekur në padi, atë ditë M.1 nuk më ka thënë asgjë dhe nuk më ka penguar herën e fundit. Prej vitit 2001 tri here e kam lajmëruar stacionin policor, pasi që F. më ka thënë dil nga shtëpia shko në kotec tanin se aty e ki vendin dhe nuk e ke vendin këtu. M.1 i ka larguar kojshit dhe punëtorin dhe i ka kërcënuar duke ju thënë se nëse ju hyni në këtë pronë kam për t’ju lajmëruar në polici. Kërkoj që nëse kam të drejtë për të qëndruar e qetë pa pengesa se unë kurrë askënd nuk e pengoj.

I padituri F.R gjatë shqyrtimit kryesor i proceduar në cilësi të palës ka deklaruar: posedimin e fundit pra muajit Qershor të 2023 e ka pasur paditësja me datë 01.06.2023 atë ditë se në cilën kohe për momentin nuk më kujtohet ka ardhur për një punëtor të cilën e ka porositur motra M. dhe ai ka filluar që të punoj dhe kjo ka qenë së bashku me të dhe e ka lënë derën e hapur ai djali, janë dal pulat jashtë pronës e cila është e rrethuar unë e kam parë nga dritarja se pulat kanë dal unë jam me asëm dhe kam pengesa në frymarrje dhe kam dal e kam thirr zotëri a ka mundësi me mi shti qato pula dhe mbylle qatë derë. Ai ka dal i ka kthyer pulat dhe e ka mbyll derën e oborrit dhe i ka mbledh veglat dhe i ka thënë paditëses se unë po shkoj dhe kjo i ka thënë ti rri se unë merrna me të dhe më ka thënë çka po donë prej meje unë i kam ngritur duart lartë me kuptim që largohu dhe më pastaj i ka njoftuar policinë, punëtori i cili ka qenë atë ditë ka qenë edhe më parë, problemi qëndron se kjo donë me be ashtu siç dëshiron dhe nuk donë askush meja prish. Ndoshta i kam thënë para një kohe kur ka filluar të investoj aty që të mos e bëjë, për arsye se kjo ka pretenduar me përvetësua për vete, ajo ma ka thënë këtë, kjo shtëpi është e vëllait dhe se për të janë kujdesur fëmijët e mijë dhe më së shumti motra M.1, në kohën e pensioneve M.. Nuk besoj dhe nuk e di që e kam sulmuar ndonjëherë M. dhe nuk e di se kush i ndihmon dhe nuk e di se i kam penguar ndonjëherë.

E paditura M.R.1 e proceduar në cilësi të palës ka deklaruar: nga viti 2018 është në shfrytëzim nga paditësia M., unë atë ditë kamë qenë në vendin e punës më kanë marrë në telefon që të dytë edhe M. edhe F. ka qenë i pari dhe unë i kam thënë mos u merr me te dhe unë më pastaj e kam

telefonuar M. dhe i kam thënë ka është problemi, më ka thënë se nuk po më lenë në investim dhe unë i kam thënë se ti je pranë vetëm me jetu por jo me investu vëllai me ka thënë përmes telefonit se M. mi ka thirr policinë pa i bërë asgjë, por djali i cili ka qenë na kemi mirëkuptim me të e të cilin e kam marr në telefon dhe e kam pyetur P. bac çka është bërë me ka thënë se asgjë vetëm se F. me ka thënë pulat futi ne oborr dhe mbylle derën dhe unë i kam thënë P. bac largohu menjherë prej aty ta shohim se çka po kërkon, M. më ka thënë përmes telefonit se nuk është punë për ty dhe kjo nuk dëshiron me te vetin por vetëm me të huajin. Pas këtij problemi unë është e vërtetë që me mirëkuptim i kam njoftuar kojshit, M. kujdeset për një plak të moshuar i cili është fqinjë më parë është kujdesur edhe për bashkëshorten e tij por ajo ka vdekur por tani ka mbetur vetëm plaku, plaku po vinë dhe pe mat oborrit e huaj ne hapa dhe nuk e kuptoj me çfarë guximi vjen dhe e bënë një gjë të tillë, unë i kam thënë se çka po bënë në oborr te huaj, ka thënë se M. me ja nda 4 ari që i takon, unë i kam thënë se nuk ke punë tjetër, dhe i kame thënë dileme prej oborrit më ka thënë se a e din se kush jam unë, i kam thënë se këmbët ti thyej po mund te them se ai është shumë provokant. Pretendimi për aktin e pengim posedimit me sa e di unë është vetëm për një datë dhe atë mundet me kanë Qershori, M. në telefon i kam thënë mos mu marr me djalin, nga se ajo nuk din me u ndal, mund të jetë e momentit diçka F. është i sëmur por unë duhet të jem aty, vazhdimisht e provokon F. por prej meje ik, nuk jam në dijeni se F. ti ketë thënë largohu, mirëpo unë i kam thënë që të largohet pasi ajo ka thënë se këtë shtëpi muaj me përkthye me qit mbi vete, du me marr hisen teme dhe me rrethua, ndërsa unë i kam thënë se hisen tënde askush nuk ta ndal, është që të takon, ndërsa për shtëpi të vëllait që është lejuar me qëndrua dhe për te ka kush e trashëgon ngase i ka fëmijët e tij, përndryshe nëse kërkon hise shtëpinë duhet me liru. Njerëzit që i kanë ndihmuar M. nuk i kam penguar.

Dëshmitari D. I. ka deklaruar: njihem mire me palët ndërgjyqëse dhe se M. e kam si vajzën time, M. pengohet nga vëllai dhe nga motra në shfrytëzimin e shtëpisë dhe oborrit, M. është e sëmur dhe po kjo po thotë se nuk po më lejnë me shfrytëzua, ndërsa unë nuk kam qenë prezent kur kjo është penguar vetëm kur më ka thirrur pastaj e kam dërguar në spital disa herë, të M. kam qenë diku 3 herë dhe M.1 ka kërkuar që të mos shkojë aty, ku e njëjta më ka telefonuar dhe më ka thënë a mundesh me ardh tek dugaja, përballë shtëpisë, ku ka kërkuar nga unë që të mos të paraqitem tek shtëpia e vëllait të saj tani i ndjerë.

Gjykata me rastin e vendosjes, e pas administrimit të te gjitha provave prezent në shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 103, 113 par.1 dhe par.2 të të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), dhe nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se *“personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”*. Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se *“ nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës... ”*, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se *“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*.

Sipas dispozitës së nenit 480, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, shprehimisht parasheh se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1, të LPK -së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditëses e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7.1, 319.1, 321, 322 dhe 480, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditëses është në tërësi e pabazuar për faktin se me provat e administruara, paditësja nuk e ka argumentuar mënyrën si është kryer akti i pengim posedimit në pjesën ku janë dyert e oborrit pjesën kontestuese kush, ku, kur dhe në ç' mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480, të LPK-së, rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar të tri kushtet esenciale për institutin e pengim posedimit e që janë : kushti i parë pushtetin e fundit faktik, këtë rrethanë se paditësja e ka pasur në posedimin-shfrytëzim pronën – shtëpinë gjykata e ka vërtetuar nga dalja në teren, nga dëgjimi i palëve ndërgjyqësve, ku edhe të paditurit e kanë pohuar së paditësja e ka në posedim pronën përkatësisht shtëpinë dhe oborrit ku pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit, ku i padituri i parë në cilësinë e palës ka deklaruar se posedimin e fundit pra në muajin qershor të vitit 2023 e ka pasur paditësja, po ashtu e paditura e dytë ka deklaruar që nga viti 2018 kjo pronë është në shfrytëzim nga paditësja. Ndërsa sa i përket afatshmërisë akti pretendohet se ka ndodhe me datë 01.06.2023, ndërsa padia është dorëzuar me datë 20.06.2023, pra çka do të thotë së padia është parashtruar brenda afatit ligjore.

Por, nuk është plotësuar kushti i treta që ka të beje me kush, ku, kur dhe në ç' mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar, nga provat e administruara, nga dëgjimi i palëve ndërgjyqëse në cilësi të palëve si dhe nga dëgjimi i dëshmitarit D.I i cili ka deklaruar se nuk ka qenë prezent në momentin kur pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit, këtë e ka dëgjuar vetëm nga paditësja e cila i ka thënë se po pengohet nga vëllau dhe motra në shfrytëzimin e shtëpisë dhe oborrit. Paditësja në cilësinë e palës ka deklaruar se jam penguar nga paditësi në mënyrë verbale dhe me ka thënë “kurvë” , “prostitutë” dhe më ka thënë me dal prej aty se unë e kam pastruar vetë pa më ndihmuar askush dhe herën e parë kur ka ndodhur më ka mbrojtur M.1 ne vitin 2022 ndërsa herën e dytë askush. I padituri i parë më datë 13.04.2023 më ka thënë me dal prej aty, ndërsa me datë 15.04.2023 ka qenë kërkesa e njëjtë që unë ta liroj atë shtëpi, ndërsa me datë 01.06.2023 unë atë ditë e kam thirre një punëtor me pastrua oborrit dhe rrugën ku kaloj, ka ardhur punëtori ka filluar që të punoj ka kryer pak, pas asaj kohe ka dalur F. nga shtëpia në oborr dhe i ka thënë punëtorit langov dil dhe shtini pulat brenda dhe atë urgjent pasi që dera e oborrit ka qenë pak e hapur dhe atë e kam e hap unë dhe jo që e kam bërë me qëllim por për shkak të punëve që kam kryer jam ngatërruar, dhe unë aty kam ndërhyrë duke i thënë punëtorit le se unë

merrem me këtë punë dhe i kam thënë se çka je ka donë, ka filluar që të më ofendoj me fjalë të ndryshme, unë i kam thënë të më lëri të qetë por ofendimet e tij kanë vazhduar dhe jam dal dhe e kam thirrur policinë, ndërsa e paditura e dytë M.1 herën e fundit kur ka ndodhur është data e cekur në padi, atë ditë M.1 nuk më ka thënë asgjë dhe nuk më ka penguar herën e fundit. M.1 i ka larguar kojshit dhe punëtorin dhe i ka kërcënuar duke ju thënë se nëse ju hyni në këtë pronë kam për t'ju lajmëruar në polici. Kërkojë që nëse kam të drejtë për të qëndruar e qetë pa pengesa se unë kurrë askënd nuk e pengoj.

Në rastin konkret gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, për shkak se për tu dhënë mbrojtja gjyqësore në procedurën e pengimit të posedimit duhet të plotësohet në mënyrë kumulative kushtet dhe atë: që paditësi të ketë pushtetin faktik, respektivisht të jetë poseduese dhe të ekzistojë pengimi i posedimit në mënyrë të dhunshme, apo me kërcënim serioz. Duke shtuar se pengimi i posedimit mund të kryhet në dy mënyra dhe atë: në bazë të shqetësimit dhe marrjes së posedimit, respektivisht privimit në mënyrë të pa drejtë nga posedimi, por edhe në mënyrë verbale me kusht që shqetësimi nga posedimi të jetë serioz, dhe nëse ka ndikuar në shkaktimin e posedimit të drejtës ose kryerjes së të drejtës së posedimit. Gjykata këtë rast e ka trajtuar relativisht në mënyrë të kujdesshme çështjen e pengimit të posedimit në mënyrë verbale, duke theksuar se pengimi i posedimit mund të kryhet në mënyrë verbale në atë mënyrë që shkaktuesi i pengimit të posedimit ia vë në dije poseduesit të sendit se do ta sulmojë jetën, trupin ose pasurinë e tij, ose poseduesit ka për t'i sjellë një të keqe shumë të madhe. Në rastin konkret nuk mund të konsiderohet se është kryer akti i pengim posedimit në mënyrë verbale, për shkak nga provat e administruara nuk është provuar se ka pasur kërcënim të natyrës serioze nga ana e të paditurve, nga i cili paditësja nuk e ka ushtruar posedimin e sendit, dhe as të drejtës së vet, përkatësisht se të paditurit nuk i ka komunikuar se do t'i sulmojë jetën, trupin, pasurinë apo se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe shumë të madhe nëse nuk largohet nga posedimi.

Së pengimi i posedimit në mënyrë verbale është i mundur dhe mbrojtja gjyqësore duhet të ofrohet në qoftë se plotësohet kushti që kërcënimin të jetë seriozë për jetën apo pasurinë e poseduesit të sendit. Sido që të jetë në çdo rast edhe kur pengimi i posedimit kryhet me veprime fizike, por edhe kur kryhet në mënyrë verbale do të konsiderohet pengim i posedimit, në qoftë se poseduesi e ka pasur posedimin e fundit deri në momentin e kryerjes së aktit të posedimit në çfarë do forme dhe akti i pengimit të posedimit ka ndikuar në shqetësimin e pengimit të posedimit apo privimit nga posedimi.

Posedimi si term ka të bëjë me pushtetin faktik mbi send dhe nuk i referohet pushtetit juridik, ndërsa pengimi në posedim ka të bëjë me shqetësimin apo pengimin në shfrytëzimin e pushtetit faktik apo zhveshjes nga pushteti faktik dhe assesi aspektit juridik sepse këtu kemi të bëjmë me natyrën tjetër të kontestit.

Sa i përket shpenzimeve gjykata vendosi duke iu referuar dispozitës së nenit 463.1 dhe 463.2 të LPK – së.

Bazuar në nenet, 103, 113 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, nenit 480 të LPK-së, lidhur me nenin 142.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG
Departamenti i përgjithshëm -Divizioni Civil C.nr. 680/23, me datë: 27.05.2024

Gj y q t a r i
Shemsedin Haxhiaj

Udhëzim juridik :

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.